



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

Vlerësimi Institucional
i Institucioneve të Arsimit të Lartë në
Shqipëri

**Raporti i Akreditimit Institucional Periodik të
Universitetit “Barleti”**

Shtator 2021

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Florim Grajcevci Kryetar
2. Anila Hoda Anëtar
3. Chris Richter Anëtar

Tabela e përmbajtjes

Rreth këtij vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raport i përmbledhur	6
Përmbledhje e gjetjeve	10
Praktika e mirë	10
Dobësitë	10
Rekomandime	10
Pohimi i veprimit të ndërmarrë	11
Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi	11
Gjykim i përmbledhur	11
Raporti i detajuar	12
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	12
Gjetjet.....	14
Praktika e mirë.....	14
Dobësitë	15
Rekomandime	15
Pohimi i veprimit të ndërmarrë.....	15
Gjykimi	15
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	16
Gjetjet.....	17
Praktika e mirë.....	18
Dobësitë.....	18
Rekomandime.....	18
Pohimi i veprimit të ndërmarrë.....	18
Gjykimi.....	18
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	19
Gjetjet.....	20
Praktika e mirë.....	20
Dobësitë.....	20
Rekomandime.....	20
Pohimi i veprimit të ndërmarrë.....	21
Gjykimi.....	21
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Gjetjet.....	23
Praktika e mirë.....	23
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	25
Lista e evidencave	27
Lista 1	27
Lista 2	29
Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës	30

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA dhe të vlerësuesve shqiptarë të caktuar nga APAAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga vlerësues ekspertë të arsimit të lartë nga Kosova, Gjermania dhe Shqipëria.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesit që ofruhet e arsimit të lartë zbatohet për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyqimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit e përmbyllin procesin duke rekomanduar një gjykim të përmbledhur për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm këshilla dhe asistencë të specializuar, duke u siguruar që

grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrektuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti “Barleti” është një institucion privat i arsimit të lartë në Shqipëri. Universiteti u themelua në vitin 2005 nën drejtimin e Bordit të Administrimit, i përbërë nga intelektualë të mirënjohur të botës së shkencës dhe politikës në Shqipëri. Qeveria e Shqipërisë, me anë të Vendimit Nr. 571, datë 12.08.2005, dha leje për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare (SHLU) të quajtur “Marin Barleti”, e cila përfshinte Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. Me anë të Vendimit Nr. 2365, datë 12.04.2006, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi hapjen edhe të dy fakulteteve të tjera nga SHLU “Marin Barleti”, konkretisht të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe Fakultetit të Shkencave Humane. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me Urdhrin Nr. 213, datë 03.07.2020, miratoi riorganizimin e IAL-së nga Shkolla e Lartë Universitare “Universiteti Marin Barleti” në Universitetin “Barleti” (UniBa), të përbërë nga tre fakultete.

UniBa synon të krijojë një model të zbatuar të Universitetit, në të cilin aktivitetet e zhvilluara grupohen në pesë drejtime kryesore, që janë: Akademike, studentët në qendër të vëmendjes, kërkimi i aplikuar dhe novacioni, administrative dhe bashkëpunuese, dhe drejtimi i sipërmarrjes. Ndërsa në këtë dekadë synon të shndërrohet në një institucion digjital.

Universiteti “Barleti” përfshin Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Këto fakultete zhvillojnë programe të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, programin e ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” dhe “Master Profesional”, si dhe programe profesionale 2-vjeçare. Në total zhvillohen 32 programe studimi; 11 programe Bachelor, 16 Mastera Profesionalë dhe Mastera Shkencorë, dhe 5 programe studimi profesionale dyvjeçare. Në total ka 10 departamente. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative ka tre departamente: Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike, Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit, dhe Departamentin e Industrive Kreative. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ka tre departamente: Departamentin e Drejtësisë, Departamentin e Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, dhe Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ka katër departamente: Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, Departamentin e Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit, dhe Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit. **[RVV, f. II-10; informacion mbi IAL-në faqen e vlerësimit të ASCAL-it]**

Raport i përmbledhur

UniBa është universitet privat në Shqipëri që përbëhet nga tre fakultete (Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit), një Qendër Trajnimi dhe Testimi (BTTC) dhe 10 departamente administrative. UniBa ofron programet e mëposhtme: 9 programe studimi trevjeçare të ciklit të parë BSc me 180 ECTS, 2 programe studimi të integruara 0+5 MSc me 300 ose 360 ECTS, 8 mastera profesionalë me 60 ose 120 ECTS, 6 Mastera Shkencorë me 120 ECTS, dhe 5 programe studimi dyvjeçare me 120 ECTS. UniBa ka të punësuar 85 punonjës akademikë me kohë të plotë dhe stafi i kontraktuar akademik ndryshon më shpesh nga njëri semestër te tjetri, si dhe ka 1704 studentë aktivë.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional për UniBa, për të vlerësuar se deri në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë, që hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë në shtator 2016 përfshiu disa praktika të mira, nuk dha asnjë rekomandim për karakteristikën në raport, por në Vendimin Nr. 9, datë 07.04.2017, për blerjet nga Bordi i Akreditimit, jepën dy rekomandime për “Universitetin Marin Barleti”, i cili duhet të shqyrtojë: (1) përmirësimin e mëtejshëm të fondit të bibliotekës, veçanërisht me librat bazë në gjuhën shqipe për programet e studimit BSc dhe përshtatjen e këtyre strukturave për akses më të mirë nga studentët, (2) Universiteti duhet të vijojë ruajtjen e traditës së mirë të marrëdhënies student-staf akademik sipas standardit ligjor. Në veçanti, kjo duhet të reflektohet me shtimin e stafit akademik me përvojë, duke pasur parasysh rritjen e të ardhurave nga studentët në 2-3 vitet e shkuara. Nuk janë identifikuar dobësi dhe është bërë një konfirmim i veprimit të ndërmarrë për zhvillimin e sistemit të ri online për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit, për të promovuar akses më të gjerë për stafin dhe studentët. Raporti i parë i akreditimit i cilësoi gjykimet për secilën Fushë Vlerësimi si plotësisht të përmbushura.

Në dhjetor të vitit 2016, vlerësuesit i rekomanduan Bordit të Akreditimit se Shkolla e Lartë Universitare “Universiteti Marin Barleti” i kishte **përmbushur plotësisht** Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe SHLU “Universiteti Marin Barleti” iu dha akreditimi nga Bordi për një periudhë gjashtëvjeçare (duke filluar nga 21.09.2017 deri më 06.04.2023).

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga Grupi i Punës së Vetëvlerësimit të Brendshëm që përfshiu 6 persona nga universiteti me njohuri të thella të institucionit, dhe një përfaqësues të këshillit studentor. Përpara se të finalizoheshin, projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në universitet.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, në datat 22 dhe 23 qershor të vitit 2021. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga tre anëtarë stafi ekspertë të arsimit të lartë nga Kosova, Shqipëria dhe Gjermania. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i pranishëm në UniBa gjatë vizitës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri për Vlerësimin e Jashtëm dhe një mbajtës shënimesh i punësuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe portofolin me të dhënat mbështetëse pesë javë përpara vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, më pas i plotësuar me dokumentacion shtesë, përpara dhe gjatë vizitës. Larmia e madhe e informacionit të vënë në dispozicion nga UniBa i mundësoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të njëjtoj me organizimin e UniBa, strukturën e saj, procedurat e menaxhimit dhe metodologjinë e përdorur për mësimdhënien, si dhe veprimtarinë kërkimore të kryer. Evidencat përfshinë Statutin dhe Rregulloret, rregulloret e programit të studimit, raportet e brendshme të ndryshme, raportet e auditimit, listën e veprimtarive të UniBa, modelin e studimit të tregut, Strategjinë e Universitetit dhe evidencat e mbledhjeve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, stafin administrativ dhe mbështetës, grupin e vetëvlerësimit, si dhe me partnerë të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime nga anëtarë mbështetës të ASCAL-it. Gjatë vizitës në terren, diskutimet mundësuan qartësimin e procedurave, organizimit të brendshëm të IAL-së, përgjegjësive dhe gjetjeve.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, por nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha asnjë rekomandim. Për sa u përket rekomandimeve që iu lanë Bordit të Akreditimit, vendimi i akreditimit të parë kishte të bënte me faktin që: UniBa të adresonte si çështje me prioritet të lartë përmirësimin e mëtejshëm të fondit të bibliotekës, veçanërisht me librat bazë në gjuhën shqipe për programet e studimit BSc dhe përshtatjen e këtyre strukturave për akses më të mirë nga studentët, dhe që Universiteti të vijonte ruajtjen e traditës së mirë të marrëdhënies student-staf akademik sipas standardit ligjor. Për rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte në gjendje të konfirmonte se rekomandimet e mbetura ishin adresuar plotësisht.

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një praktikë të mirë: dokumentimin e proceseve **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**, dy dobësi: infrastrukturën e pamjaftueshme për realizimin me sukses të programeve të studimit për sportet, si dhe faqja e internetit që është e disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, çka nuk iu mundëson studentëve të huaj të mësojnë rreth UniBa **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**, dhe tre rekomandime: dy nga rekomandimet lidhur me adresimin e dobësive dhe i treti lidhur me faktin që stafi i UniBa të jetë më inkurajues për veprimtaritë kërkimore. Së fundi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një praktikë të mirë: programet e zhvillimit të vazhdueshëm për stafin **(Kapitulli I, Standardi I.2)**, por nuk identifikoi asnjë dobësi ose pohim të veprimeve të ndërmarra, dhe dha një rekomandim: Për sa u përket prirjeve/objektivave, bazuar në intervistat e zhvilluara me një grup studentësh të ciklit të dytë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se studentët e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike janë pak ose aspak të ekspozuar ndaj moduleve me burime të hapura, të cilat përdoren gjerësisht në industri (GitHub, docker, AWS, e kështu me radhë). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon se kjo duhet adresuar edhe në syllabuset e lëndëve. **(Kapitulli I, Standardi I.4)**

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë: ekipi i volejbollit për femra që luan në superligë, si dhe 15 klube studentore aktive që organizojnë aktivitete si forume, workshop-e, programe trajnimi **(Kapitulli I, Standardi III.8)**. Nuk është identifikuar asnjë dobësi, nuk është dhënë asnjë rekomandim ose nuk është pohuar asnjë veprim tashmë i zbatuar.

UniBa kreu vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerësoi shkallën e angazhimit të Universitetit në proces dhe bashkëpunimin që iu ofrua përgjatë fazës së vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Prof. Ass. Dr. Florim Grajcevci (Kryetar), Prof. Anila Hoda dhe Dr. Chris Richter (Anëtarë).

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Universiteti Barleti ka një bashkëpunim mjaft të ngushtë me institucionet private kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'u siguruar studentëve mbështetjen e duhur gjatë trajnimit praktik, si dhe për punësimin e tyre në të ardhmen. **(Kapitulli III Standardi III.3)**
- Kryhet dokumentim i mirë i proceseve. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**
- Programe të zhvillimit të vazhdueshëm për stafin. **(Kapitulli I , Standardi I.2).**
- Ekipi i volejbollit për femra që luan në superligë, si dhe 15 klube studentore aktive që organizojnë aktivitete si forume, workshop-e, programe trajnimi . **(Kapitulli I Standardi III.8)**

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Ambientet e brendshme sportive aktuale janë shumë të vogla. Megjithëse zgjidhja e gjetur nga UniBa është disi e mjaftueshme për të zhvilluar programet sportive, nuk ka qëndrueshmëri në planin afatgjatë. Partnerët e jashtëm mund të zgjidhin kontratat dhe vazhdimësia e orëve mësimore që kërkojnë ambiente nuk garantohet (për shembull, distanca nga strukturat e disponueshme mund të bëhet më e madhe. **(Kapitulli III, Standardi V.1; Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII. 5)**
- Megjithëse UniBa ka një sistem informacioni të mirorganizuar, përmbajtja e faqes së internetit është e disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, dhe përmbajtja e saj duhet të përkthehet në gjuhë të tjera për t'iu mundësuar studentëve të huaj të mësojnë rreth UniBa. **(Kapitulli III, Standardi VII.1).**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Institucioni duhet të shtojë në strukturën e tij ambiente sportive në funksion të realizimit të programeve të studimit me karakter sportiv. Në këtë mënyrë sigurohet pavarësi nga marrëveshjet me institucione partnere për përdorimin e ambienteve të tyre sportive. **(Kapitulli III, Standardi V.1)**
- Rekomandohet që faqja e internetit e universitetit të jetë e disponueshme edhe në gjuhë të tjera, përveç shqipes, në mënyrë që studentët e huaj të mësojnë rreth UniBa. **(Kapitulli III, Standardi VII.1).**
- Megjithëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nxit kërkimin, një punim “i mirë” i rishikuar nga kolegët në vit është shumë. Disa anëtarë të stafit mund të kenë

nevojë për shumë muaj që të mbledhin të dhëna ose mund hasin vështirësi me aftësitë gjuhësore. Ky faktor i kufizon anëtarët e stafit të kryejnë punë të mirë kërkimore dhe i lejon anëtarët e stafit të kërkojnë për zgjidhje të shpejta në vend të zhvillimit afatgjatë të aftësive. Rrjedhimisht, mund të përshtaten kriteret e një botimi të rishikuar nga kolegët. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**

- Për sa u përket prirjeve/objektivave, bazuar në intervistat e zhvilluara me një grup studentësh të ciklit të dytë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se studentët e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike janë pak ose aspak të ekspozuar ndaj moduleve me burime të hapura, të cilat përdoren gjerësisht në industri (GitHub, docker, AWS, e kështu me radhë). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon se kjo duhet adresuar edhe në syllabuset e lëndëve. **(Kapitulli I, Standardi I.4)**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra.

Gjykime përmblendhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmblendhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin Barleti, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përbushur plotësisht.

Raport i detajuar

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Universiteti “Barleti” e kryen veprimtarinë akademike dhe shkencore mbështetur në aktet ligjore në fuqi, statutin e tij, si dhe akte të tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet e tij qeverisëse. Ai është një institucion jopublik i arsimit të lartë dhe u themelua në vitin 2005. **[RVV f. 9]** Organet qeverisëse të IAL-së UniBa janë Rektorati, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Bordi i të Besuarve dhe Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta. **[Ref.1_EN; Mbledhjet 1,2,3]** Në vitin 2020, IAL-ja u ristrukturua nga Shkolla e Lartë Universitare “Universiteti Marin Barleti” në Universitetin “Barleti” (UniBa). Statuti përcakton parimet bazë, misionin, vizionin dhe strukturat e organizimit dhe menaxhimit të brendshëm. **[Ref. 1_EN, Ch1 dhe Ch2]** Organi akademik qeverisës më i lartë është Senati Akademik. Rektori është kryetar i Senatit Akademik. Anëtarësia e Senatit Akademik përfshin Rektordin. Rishikimi i fundit i rregullores së UniBa u bë në vitin 2021, duke pasur parasysh ndryshimet më të fundit në kërkesat ligjore, si dhe ndryshimin strukturor dhe vetë Statutin. **[RVV f. 13] (Kapitulli III, Standardi I.1)**

1.2 UniBa është organizuar për të siguruar eficiencë menaxhimi në përputhje me kërkesat ligjore, rregulloret dhe Planin e Zhvillimit Strategjik 2020-2030. **[Ref.1_EN; Ref.2_EN; Ref.3_EN]** Organet vendimmarrëse më të larta janë Senati Akademik, Bordi i Administrimit dhe Bordi i të Besuarve, të cilët mundësojnë administrimin e veprimtarisë akademike dhe financiare të universitetit. **[Ref.3_EN, Mbledhjet 1-6]** Studentët përfaqësohen në Senat nëpërmjet zgjedhjes së një përfaqësuesi të tyre. **[Ref1_EN, faqe 10]** Rregullimet për menaxhimin dhe administrimin e Institucionit dhe për vendimmarrjen kolegjiale marrin në konsideratë pritshmëritë ligjore, funksionojnë në mënyrën e duhur dhe respektojnë transparencën. **[RVV f. 13; Ref.1_EN; Ref.2_EN; Ref.3_EN; Ref.4; Ref.5_EN] (Kapitulli III, Standardi I.2)**

1.3 Organet drejtuese të UniBa mbledhen rregullisht, në përputhje me parashikimet e rregulloreve specifike për funksionimin e tyre. **[RVV f. 14; Mbledhja 1; Ref.11_EN; Ref.30_AL; Ref.44_AL]** Senati, si organi akademik kolegjial më i lartë i Universitetit, e kryen veprimtarinë e tij në mbledhje periodike. Vendimet për operacionet e IAL-së nga bordet dhe diskutimet kolegjiale kuptohen nga stafi akademik dhe studentët. **[RVV f. 14; Mbledhjet 2,4,5]**. Dekanët, krerët e Institucioneve dhe shefat e departamenteve janë përgjegjës në lidhje me mbikëqyrjen e veprimtarisë kërkimore në nivel Fakulteti. **[Ref.1_EN. Mbledhjet 7,8] (Kapitulli III, Standardi I.3)**

1.4 UniBa ofron një strukturë për mundësi debatesh të hapura, duke përfshirë stafin akademik, studentët dhe drejtuesit. Këto debate zhvillohen në nivel departamenti, fakulteti dhe institucional, me vendime përfundimtare që i takojnë Kryetarit të Senatit Akademik ose Rektorit. Qeverisja është e dukshme në njësitë akademike organizative dhe në administratë. **[RVV f. 14; Ref.1_EN; Ref.3_EN]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Zhvillimit Kurrikular luan një rol kryesor në monitorimin dhe analizimin e efektivitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. UniBa kujdeset për sigurimin e cilësisë nëpërmjet organit kolegjial të Komisionit për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili ofron udhëzime, këshilla dhe

mbështetje. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjës për sigurimin e përputhshmërisë me standardet e cilësisë. **[Ref.1; Ref.3; Mbledhjet 2,3,6]** Bordi i Karrierës i UniBa, në bashkëpunim me departamentet, synon të përmirësojë programet e studimit dhe përshtatjen me kërkesën e tregut. **[RVV f. 15] (Kapitulli III, Standardi I.4)**

1.5 UniBa ka hartuar strategjinë e duhur të zhvillimit për zhvillimin institucional në formën e Planit Strategjik 2020-2030, i cili përmban misionin, vizionin dhe objektivat e tij. **[RVV f. 15; Ref.2; Mbledhja 3]** Strategjia ka përshkrim shumë të gjerë për të arritur disa qëllime dhe objektiva. Strategjia e IAL-së përmban pesë shtylla për zhvillimin dhjetëvjeçar të Universitetit, për t'u shndërruar në "Universitet digjital" dhe Universitet aplikativ. Zhvillimi i Planit Strategjik 2020-2030 adreson plotësisht të gjitha çështjet e IAL-së, siç janë veprimtaria kërkimore e Universitetit, sipërmarrja në partneritet dhe organizimi dhe qeverisja. **(Kapitulli III, Standardi I.5)**

1.6 Raporti vjetor (2019-2020) për Ministrinë e Arsimit përmban të dhëna për mësimdhënien dhe programet e studimit, kërkimin shkencor, rekrutimin e stafit, veprimtarinë e projektit. **[RVV f. 15; Ref.8_EN; Ref.9_EN]** Raportet përfaqësojnë veprimtaritë institucionale periodike gjatë vitit akademik. Procesi i hartimit mbështetet në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të vetëvlerësimit nga secila Njësi Kryesore dhe Bazë. Raportet u mbështetën në të dhënat e performancës së studentëve, pranimin dhe përputhshmërinë me rregulloren. **[Mbledhja 2]** Raportet vjetore të IAL-së paraqesin sfidat e organizimit të veprimtarive akademike, duke pasur parasysh tërmetin që ndodhi në nëntor të vitit 2019 dhe pandeminë COVID-19. Raportet i janë vënë në dispozicion stafit dhe studentëve nëpërmjet intranetit të institucionit. **[RVV f. 15] (Kapitulli III, Standardi I.6)**

1.7 UniBa dhe tre fakultetet dhe departamentet e saj janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV f. 15,16]** Strukturat drejtuese ekzekutive dhe administrative janë përfshirë kryesisht në pjesën akademike të institucionit. **[Mbledhja 3]** Stafi akademik është i kualifikuar si duhet dhe ushtron autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie. **[Ref.1_EN; Mbledhjet 2,3,4]** UniBa ka një faqe interneti zyrtare dhe ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në përputhje me statusin e tij juridik. **[RVV f. 16; Ref.1_EN; informacion për IAL-në në faqen e APAAL-it www.umb.uni.al, Mbledhjet 2-4] (Kapitulli III, Standardi II.1)**

1.8 Statuti i UniBa përcakton saktë kompetencat e organeve qeverisëse dhe vendimmarrëse kolegjiale. Senati Akademik garanton përfaqësim të plotë të të gjitha niveleve dhe njësive të IAL-së. **[RVV f. 16; Ref.1_EN]** Njësia kolegjiale bazë janë departamentet, në të cilat mund të marrë pjesë i gjithë stafi akademik për të diskutuar kontributin për interesa të ndryshme institucionale. **[Mbledhja 7]** Dekanati në nivel fakulteti organizon veprimtari mësimore, kërkimore dhe administrative. **[RVV f. 16; Ref.4_EN]** Senati Akademik i UniBa ka zgjedhur një anëtar të Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka kompetencë lidhur me etikën në veprimtarisë mësimdhënëse, kërkimore dhe institucionale. **[Ref.1_EN] (Kapitulli III, Standardi II.3)**

1.9 UniBa është lehtësuar falë angazhimit të specialistëve të suksesshëm në mësimdhënie në IAL, dhe falë partneritetit të saj të jashtëm merr informacion mbi tregun në lidhje me përmbushjen e misionit dhe vizionit të IAL-së. Zyra e Karrierës dhe Alumnit monitoron

punësimin e të diplomuarve dhe menaxhon orientimin e karrierës për studentët, duke i përgatitur ata për kërkesat e tregut të punës. UniBa ka mbledhur të dhëna nga studentët e punësuar, sipas të cilave përqindja e studentëve të punësuar arrinte në 70% për programet e studimit Bachelor dhe 80% për programet e studimit Master **[RVV f. 17; Ref.22_EN; Mbledhja 6]** UniBa investon në një fond për të rritur ndërgjegjësimin rreth programeve të studimit për brezat e studentëve të rinj, duke i përgatitur studentët për tregun e punës, industrinë e biznesit. **[RVV f. 17; Ref.35_EN; Mbledhja 6] (Kapitulli III, Standardi III.1)**

1.10 UniBa i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione të tjera duke qenë aktive në këtë aspekt, nëpërmjet bashkëpunimit si partner në projekte të ndryshme dhe nëpërmjet ndërveprimit të ngushtë me institucione të arsimit të lartë. **[RVV f. 17; Mbledhja 6; Ref.2_EN]** Në veprimtarinë e saj, UniBa është përpjekur të gjejë ekuilibrin ndërmjet konkurrueshmërisë dhe bashkëpunimit, brenda vendit dhe në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare. Në strategjinë e saj 2020-2030, **[Ref.2_EN]** UniBa përcakton qartë zhvillimin e mëtejshëm të planit të ndërkombëtarizimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit afatmesëm dhe afatgjatë. Ndërkohë, UniBa jep evidenca për mobilitetin e studentëve jashtë vendit, organizimin e workshop-eve, konferencave, partneriteteve të projekteve **[Ref.15_EN; Ref.17_EN; Ref.19_AL; Ref.26_EN] (Kapitulli III, Standardi III.2)**

1.11 UniBa ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, organet publike dhe firmat e pavarura. **[RVV f. 18; Mbledhja 6; Ref.15_EN]** Ndërkombëtarizimi është përfshirë si tipar kyç në *Planin Strategjik 2020-2030*. **[REF.2_EN]** Studentët, stafi akademik, alumni dhe përfaqësuesit e industrisë treguan se ka lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe rajonale. **[Mbledhjet 3,6]** Lidhjet ndërmjet IAL-së, stafit akademik dhe industrive përkatëse konfirmojnë se rekomandimi për kryerjen e anketimeve mbi tregun e punës, për të mbështetur zhvillimin e kurrikulave dhe programit në të gjitha nivelet e studimit, është përmbushur plotësisht. **(Kapitulli III, Standardi III.3)**

1.12 UniBa ka lidhur disa marrëveshje zyrtare që iu mundësojnë stafit dhe studentëve të marrin pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit rritin mobilitetin e stafit dhe studentëve. **[RVV f. 18, Ref.17_EN]** Universiteti i ka mbështetur programet e mobilitetit të stafit dhe studentëve nëpërmjet edukimit ndërkombëtar të Universitetit në Evropë. **[RVV f. 18; Mbledhjet 1-3]** Të gjitha programet e studimit të Universitetit Barleti janë zhvilluar në gjuhën shqipe, dhe për këtë arsye studentët që vijnë të ndjekin studimet janë nga vendet fqinje. **[RVV f. 18] (Kapitulli III, Standardi III.4)**

1.13 Universiteti Barleti i përmbush standardet e cilësisë për menaxhimin dhe organizimin e tij, siç dëshmohet edhe nga struktura e mbledhjeve diskutuese, dhe monitorimi e vlerësimi i performancës në nivel fakulteti dhe departamenti. Strategjia e zhvillimit institucional të IAL-së do të krijojë më shumë mundësi për përparim të mëtejshëm në veprimtaritë mësimdhënëse dhe kërkimore nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit, si dhe riorganizimi dhe qeverisja duhet të ofrojë cilësi më të lartë të institucionit. Shqyrtimi sistematik i problematikave dhe planeve të veprimit, siç ndodhi në rastin e tërmetit dhe pandemisë COVID-19, është shembull i praktikës së mirë.

Praktika **e**
mirě

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Universiteti Barleti ka një bashkëpunim mjaft të ngushtë me institucionet private kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'u siguruar studentëve mbështetjen e duhur gjatë trajnimit praktik, si dhe për punësimin e tyre në të ardhmen. **(Kapitulli III Standardi III.3)**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë rekomandim në këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Në bazë të Raportit të Vetëvlerësimit Institucional të marrë, UniBa ka përcaktuar parime, kritere dhe procedura të qarta për rekrutimin e stafit në Manualin e saj të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. **[RVV f. 19; Ref.3_EN, neni 55, Ref.46_EN]** Të gjitha vendet e lira të punës janë publikuar në rrjetet sociale dhe në faqen e saj të internetit. **[RVV faqe 19; Ref.18_AL] (Kapitulli III, Standardi IV.1)**

2.2 Raporti i Vetëvlerësimit Institucional përcakton se UniBa ka përfshirë një politikë të integritit të stafit nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme, dhe se stafi i punësuar rishtazi ndihmohet nga Burimet Njerëzore dhe eprori akademik direkt. Kjo mund të konfirmohet edhe nga intervistat e kryera, sipas të cilave stafi dukej i kënaqur me praktikatat ndjekura të rekrutimit. **[RVV faqe 19] (Kapitulli III, Standardi IV.2)**

2.3 UniBa e vlerëson performancën e stafit të saj dy herë në vit, në lidhje me mësimdhënien, kërkimin dhe administrimin. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë përcaktuar qartë në dokumentin e rregullores mbi vlerësimin dhe menaxhimin e performancës. **[RVV faqe 19; Ref.19_AL] (Kapitulli III, Standardi IV.3)**

2.4 RVV-ja thekson se një nga synimet kryesore të UniBa është që të jetë/bëhet një aktor në jetën sociale dhe publike. Për këtë arsye, UniBa ka përcaktuar një larmi bashkëpunimesh me subjekte publike dhe private. **[RVV f. 20; Ref.3_EN; Ref.19_AL]** Kjo mund të konfirmohet nga intervistat e kryera. Megjithatë, ndikimi i projekteve të kryera sot ka vetëm karakter për krijimin e ideve. **[Mbledhja 2] (Kapitulli III, Standardi IV.4)**

2.5 UniBa ka rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse. **[RVV f. 20; Ref.1_EN; Ref.3_EN; Ref.46_EN] (Kapitulli III Standardi II.2)**

2.6 Raporti i Vetëvlerësimit Institucional konstaton se projektbuxhetet e UniBa janë në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin e financave publike **[RVV f. 20]**. Gjithashtu, në RVV raportohet se projektbuxhetet janë përshtatur për të lejuar strategjinë e zhvillimit afatmesëm të institucionit. Zbatimi i politikave financiare kryhet nga Zyra e Financës, me buxhet dhe kontroll financiar që ushtrohet nëpërmjet auditeve të brendshme dhe të jashtme **[RVV f. 21]**. Evidencat mbështetëse janë: **[Ref.1_EN; Ref.21_AL; Ref.48_EN; Ref.40_AL; Ref.50_AL; Ref.52_AL] (Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**

2.7 Sipas intervistave të kryera dhe Raportit të Vetëvlerësimit Institucional, UniBa ka një sistem informatik të mirorganizuar. Sistemi informatik përfshin portalin studentor **[Ref.52.9_AL]** dhe instrumente të tjera që mundësojnë të dhëna mbi menaxhimin e studentëve, menaxhimin administrativ dhe performancën akademike. **[RVV f. 21-22]** Ka në dispozicion intranet dhe një faqe interneti. Megjithatë, faqja e internetit ka përmbajtje vetëm në një gjuhë (shqip), dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që faqja e internetit të jetë në dispozicion edhe në gjuhë të tjera, për t'iu mundësuar studentëve të huaj të mësojnë rreth UniBa. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**

2.8 Gjatë gjithë pandemisë COVID, UniBa ka zhvilluar mësimin online, ndërsa anëtarët e stafit dhe studentët kanë akses në kompjutera personalë në ambientet e fakultetit **[vizitë në terren në fakultet, RVV f. 22; Ref.51_AL]. (Kapitulli III, Standardi VII.2)**

2.9 Aktualisht, UniBa ka dy kampuse. **[Ref.52.2_AL; Ref.52.3_AL]** Megjithëse disa ambiente sportive janë nën pronësinë e universitetit, shumë të tjera nuk janë, **[Ref. 52.2.3_AL]** dhe janë subjekt i kontratave me partnerët e jashtëm (ato ndodhen jashtë kampusit). UniBa ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së pasurisë së saj akademike, kulturore dhe shkencore (p.sh., mbledhje të dhënash dhe dokumentesh zyrtare mbi veprimtari të ndryshme, si: workshop-e, konferenca, botime shkencore [duke përfshirë tezat e studentëve]) **[RVV f. 22; Ref.23_EN] (Kapitulli III, Standardi VII.3 deri VII.6 – pa përfshirë VII. 5)**

2.10 Duke marrë në konsideratë faktin që studentët e UniBa janë regjistruar kryesisht në programe sportive, UniBa nuk ka (zotëron) një infrastrukturë të përshtatshme për të kryer veprimtaritë e saj [vizita në terren]. Në të ardhmen (ambientet nuk kishin përfunduar gjatë vizitës në terren), orët sportive do të zhvillohen në ambiente të posaçme (që ishin të kufizuara në hapësirë), si dhe në ambiente të tjera që janë vënë në dispozicion nga institucione të tjera falë marrëveshjeve të bashkëpunimit. **[Ref.15_EN; Ref.5_EN; Ref.84_EN] (Kapitulli III, Standardi VII. 5)**

2.11 UniBa ofron një strukturë mbështetëse për administrimin dhe koordinimin e veprimtarive të tjera. UniBa ofron akses për komunitetin në ambientet e saj sportive për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta **[RVV f. 23]** Për të siguruar cilësinë e logjistikës, pjesë e vlerësimit të brendshëm janë edhe pyetësorë dhe anketa të ndryshme. **[Ref.37_EN] (Kapitulli III, Standardi VII. 6)**

2.12 Fakultete e UniBa i përmbushin standardet e përcaktuara me ligj. **[RVV f. 23]** Ambientet janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e programeve të ofruara, përveç programeve sportive. **[Mbledhja 6; Ref.52.2_AL; Ref.4_EN; Re.5_EN]** Duke marrë në konsideratë faktin që studentët e UniBa janë regjistruar kryesisht në programe sportive, UniBa nuk zotëron infrastrukturë të përshtatshme për të kryer veprimtaritë e saj, pasi varet nga kontratat e qirasë me partnerë të jashtëm, dhe prandaj në RVV është konstatuar se nuk mund të garantohet distanca e pasurive nga zonat industriale, mjedisi i qetë dhe izolimi nga zhurma dhe lagështira. Gjithashtu, ambientet sportive në pronësi ose janë shumë të vogla (sallë gjimnastike, sallë boksi dhe sallë trajnimi force), ose kanë dysheme të ashpër jo të zakonshme (fusha e basketbollit/volejbollit). Institucioni duhet të shtojë në strukturën e tij ambiente sportive në funksion të realizimit të programeve të studimit me karakter sportiv. Në këtë mënyrë sigurohet pavarësi nga marrëveshjet me institucione partnere për përdorimin e ambienteve të tyre sportive **[vizitë në terren]**. Së fundi, kompjuterat personalë të ofruar nuk janë aq modernë sa thuhet në RVV, por mjaftueshëm për mësimdhënien [vizitë në terren] **(Kapitulli III, Standardi V.1)**

2.13 UniBa përpunon të dhëna në lidhje me fushën akademike, regjistrimin dhe informacion lidhur me programet në format elektronik dhe fizik. **[RVV f. 24; Ref.23_AL]** Statistikat në lidhje me punësimin e studentëve gjenerohen nga zyra e karrierës dhe alumni. **[RVV f. 24; Ref.22_AL] (Kapitulli III, Standardi V.2)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Kryhet dokumentim i mirë i proceseve. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Ambientet e brendshme sportive aktuale janë shumë të vogla. Megjithëse zgjidhja e gjetur nga UniBa është disi e mjaftueshme për të zhvilluar programet sportive, nuk ka qëndrueshmëri në planin afatgjatë. Partnerët e jashtëm mund të zgjidhin kontratat dhe vazhdimësia e orëve mësimore që kërkojnë ambiente nuk garantohet (për shembull, distanca nga strukturat e disponueshme mund të bëhet më e madhe. **(Kapitulli III, Standardi V.1; Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII. 5)**
- Megjithëse UniBa ka një sistem informacioni të mirorganizuar, përmbajtja e faqes së internetit është e disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, dhe përmbajtja e saj duhet të përkthehet në gjuhë të tjera për t'iu mundësuar studentëve të huaj të mësojnë rreth UniBa.
(Kapitulli III, Standardi VII.1).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Institucioni duhet të shtojë në strukturën e tij ambiente sportive në funksion të realizimit të programeve të studimit me karakter sportiv. Në këtë mënyrë sigurohet pavarësi nga marrëveshjet me institucione partnere për përdorimin e ambienteve të tyre sportive. **(Kapitulli III, Standardi V.1).**
- Rekomandohet që faqja e internetit e universitetit të jetë e disponueshme edhe në gjuhë të tjera, përveç shqipes, në mënyrë që studentët e huaj të mësojnë rreth UniBa. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**

Megjithëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nxiti kërkimin, një punim “i mirë” i rishikuar nga kolegët në vit është shumë.

Disa anëtarë të stafit mund të kenë nevojë për shumë muaj që të mbledhin të dhëna ose mund hasin vështirësi me aftësitë gjuhësore. Ky faktor i kufizon anëtarët e stafit të kryejnë punë të mirë kërkimore dhe i lejon anëtarët e stafit të kërkojnë për zgjidhje të shpejta në vend të zhvillimit afatgjatë të aftësive. Rrjedhimisht, mund të përshtaten kriteret e një botimi të rishikuar nga kolegët. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**

Pohimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Nisur nga vizita në terren, UniBa ofron programe studimi që janë në përputhje me misionin e saj, **[RVV f. 26; Ref.1_EN]** ndërsa kushtet infrastrukturore nuk janë ideale për programin sportiv. UniBa ndjek një politikë të qartë lidhur me pranimin e studentëve, me kriterë pranueshmërie dhe kërkesa testimi që rishikohen dhe miratohen nga organet kolegjiale **[RVV f. 26; Ref.1_EN, neni 55 dhe neni 11; Ref.3_EN, neni 75-77; Ref.11_EN; Ref.13 A; Ref.32_AL]** Programet e studimit janë publikuar në faqen e saj zyrtare. **(Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli I, Standardi I.1)**

3.2 Sipas intervistave të kryera, UniBa ka bërë mirë në lidhje me ofrimin e mundësive të zhvillimit për stafin. **[Mbledhja 2]** Kjo u reflektua edhe në RVV, në të cilin UniBa pohon se inkurajon të nxënit gjatë gjithë jetës **[Ref.1_EN, neni 7], (Kapitulli I, Standardi I.2)**

3.3 Programet e studimit të ofruara nga UniBa janë në përputhje me të gjithë komponentët e strategjisë së zhvillimit të institucionit **[RVV f. 26; Ref.2_EN] (Kapitulli I, Standardi I.3)**

3.4 Sipas intervistave të kryera, programet e studimit në lidhje me sportin dhe informatikën mund të përmirësohen sipas tendencave ekzistuese (p.sh., studentët e sportit nuk ishin në dijeni për institucionet e formimit të industrisë [NSCA dhe UKSC], ndërsa studentët e teknologjisë së informacionit kishin pak njohuri mbi instrumentet themelore [p.sh., docker, AWS, ruby]) [mbledhja me studentët e MA, 2:30, dita 1]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon se kjo duhet adresuar edhe në syllabuset e lëndëve. Krahas kësaj, UniBa po kryen mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimet e pyetësorit për të identifikuar nevojat e tregut të punës **[RVV f. 27; Mbledhjet 2-7]**. Së fundi, raportohet se programet e studimit janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare **[RVV f. 27; Ref.1_EN, neni 7] (Kapitulli I, Standardi I.4)**

3.5 Në bazë të Raportit të Vetëvlerësimit Institucional, ngarkesa mësimore e pedagogëve është caktuar në përputhje me rregulloret. **[RVV faqe 27 Ref.11_EN; Ref.34_EN; Ref.13/C_EN; Ref.51_AL; Ref.46_EN; Ref.47_EN] (Kapitulli I, Standardi I.5)**

3.6 Programet e studimit janë emërtuar qartë dhe informacioni i përgjithshëm mbi programet është ndarë me studentët në fillim të semestrit **[Ref.43_AL]** dhe është i disponueshëm për studentët nëpërmjet intranetit **[RVV f. 27; Ref.30_AL; Ref.3_EN, neni 75; Ref.6_EN; Ref.7_EN] (Kapitulli I, Standardi I.6)**

3.7 Programet e ciklit të parë synojnë t'iu ofrojnë studentëve njohuritë bazë, parimet dhe metodat shkencore të përgjithshme, dhe kërkojnë t'iu mundësojnë studentëve të përparojnë në ciklin e dytë ose drejt punësimit **[RVV f. 27; Mbledhja 7; Ref.1EN, neni 46; Ref.3, neni 59; Ref.6_EN; Ref.7_EN; Ref.1_EN, nenet 44-46; Ref.45_AL] (Kapitulli I, Standardi I.7)**

3.8 Programet e ciklit të parë synojnë t'iu ofrojnë studentëve njohuritë bazë, parimet dhe metodat shkencore të përgjithshme, dhe kërkojnë t'iu mundësojnë studentëve të përparojnë në ciklin e dytë ose drejt punësimit **[RVV f. 27; Mbledhjet 1-7; Ref.1_EN, nenet 44,46; Ref.3_EN, neni 59; Ref.6_EN; Ref.7_EN; Ref.45_AL] (Kapitulli I, Standardi I.8)**

3.9 UniBa po mban të dhëna mbi punësimin e studentëve [RVV f. 28] dhe ka demonstruar/dëshmuar shumë bashkëpunime me qeveritë, bizneset dhe universitetet e tjera ndërkombëtare [Mbledhja 6]. Kjo përfaqësohet nga një periudhë praktike e përcaktuar në dosjen e praktikës [Ref.41_AL] ku studentëve iu ofrohen stazhe në institucione, biznese dhe organizata jofitimprurëse. [Ref.15EN] Temat e menduara nga stafi janë në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. [Ref.51_AL] [Mbledhja 6] (Kapitulli I, Standardi I.9)

3.10 Gjatë intervistave të kryera, pati evidenca për shkëmbime të anëtarëve të stafit. [Mbledhja 3] Më tej, siç konstatohet në RVV, transferimi i krediteve është i mundur për studentët pas një shkëmbimi. [RVV f. 29; Ref.3_EN, neni 69; Ref.45_AL] Diplomat e lëshuara në fund të programeve të studimit shoqërohen nga suplemente/shtesa diplome të njohura në nivel ndërkombëtar [Ref.3_EN, neni 60; Ref.42/B_AL] dhe në rast të një shkëmbimi programi, theksi vihet te lehtësimi i mobilitetit studentor. [Ref.17_EN] (Kapitulli I, Standardi I.10)

3.11 Syllabuset e studimit janë konceptuar në kurse teorike dhe praktike për të mundësuar zbatimin në praktikë të aftësive të përfutuara në kurse teorike. [RVV faqe 29; Ref.41_AL; Ref. 42_AL; Ref.6_EN; Ref.7_EN] Gjithashtu, syllabuset e studimit janë konceptuar për të përfshirë përgatitjen dhe prezantimin e projekteve shkencore të studentëve, sipas rregullores së studimeve (tema e diplomës, teza). [RVV faqe 29; Ref.42_AL; Ref. 43_AL] (Kapitulli I, Standardi I.11)

3.12 Syllabuset e studimit janë konceptuar në atë mënyrë që t'i pajisin studentët me aftësi që janë të vlefshme për punëdhënësit. [RVV f. 29; Ref.1_EN; Ref.41_AL; Ref.19_AL] (Kapitulli I, Standardi I.12)

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Programe të zhvillimit të vazhdueshëm për stafin. (Kapitulli I, Standardi I.2).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Për sa u përket prirjeve/objektivave, bazuar në intervistat e zhvilluara me një grup studentësh të ciklit të dytë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se studentët e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike janë pak ose aspak të ekspozuar ndaj moduleve me burime të hapura, të cilat përdoren gjerësisht në industri (GitHub, docker, AWS, e kështu me radhë).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon se kjo duhet adresuar edhe në syllabuset e lëndëve. **(Kapitulli I, Standardi I.4)**

Pohimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Programet e studimit bazohen në kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë për organizimin e tyre iu takojnë fakulteteve, departamenteve dhe sekretarive. **[RVV f. 30, Ref.1, 3, 4, 5_EN]** Pedagogët punojnë në grupe për të përmirësuar përmbajtjen e kurrikulave dhe syllabuseve. **[Ref.14_EN]** Gjatë praktikave profesionale, studentët udhëhiqen dhe mbikëqyren nga pedagogë. UniBa ka kapacitete të mjaftueshme për praktikë profesionale nëpërmjet institucioneve të ndryshme, falë numrit të madh të marrëveshjeve të partneritetit. Studentët orientohen për përgatitjen dhe shkrimin e tezës nga një pedagog, në përputhje me rregulloret. **[Ref.41b_AL]** Universiteti ka bibliotekë fizike dhe elektronike me libra të shtypur dhe burime online **[RVV. f. 30]. (Kapitulli I Standardi II.1)**

4.2 Rregullat dhe kërkesat e provimit janë përcaktuar në rregulloret e UniBa **[Ref.3_EN]**. Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë përcaktuar qartë në rregulloren e UniBa dhe në rregulloret e programeve të studimit. **[Ref.3_EN; Ref.6EN; Ref.7EN]** Gjatë vlerësimit të provimeve, anonimiteti respektohet nëpërmjet një sistemi online që mundëson identifikimin individual. **[Ref.52.9_AL]** Ankimimi për pikët e provimeve dhe procedura përkatëse janë në përputhje me rregulloren e UniBa. **[Ref.3_EN]** Studentët kanë mundësinë të përmirësojnë notat e tyre siç theksohet në rregulloren e UniBa. **[Ref.3_EN] (Kapitulli I Standardi II.2)**

4.3 UniBa ka politikat e veta për përmirësimin e programeve të studimit. Stafi akademik **[Ref.37_EN]** dhe programet e studimit vlerësohen rregullisht dhe procesi realizohet nga Departamentet në bashkëpunim me Njësinë e Cilësisë dhe Zhvillimit Kurrikular, dhe rezultatet e vlerësimit përfshihen në Raportet Vjetore **[Ref.8_EN]**. Njësia përdor instrumente të ndryshme, si: pyetësorë, fokus grupe, detyra kursi ose nëpërmjet bisedave të drejtpërdrejta me studentët. Këto të dhëna dhe të dhënat mbi punësimin e studentëve **[Ref.22_AL]** përdoren nga Universiteti për të përmirësuar programet e studimit. **(Kapitulli I Standardi II.3)**

4.4 Stafi akademik trajnohet nga pedagogë mjaft të kualifikuar ose nga pedagogë të ftuar. Stafi akademik dhe stafi akademik ndihmës janë përfshirë në mobilitetin për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe trajnim nëpërmjet projekteve ndërkombëtare. **[Ref.20_AL]** UniBA organizon konferenca, diskutime, forume, workshop-e ose komunikime online. Universitetit është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe iu ka ofruar studentëve orare, leksione, etj., për të realizuar programet e studimit. Universiteti përdor metoda të të nxënies elektronik dhe burime online, si platforma Google Classroom, **[Ref.28_EN]** të cilat janë shumë efektive, sidomos gjatë vitit të pandemisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Universitetit përdor pyetësorët e studentëve **[Ref.37_EN]** për të vlerësuar burimet e të nxënies. **(Kapitulli I Standardi II.4)**

4.5 Departamentet janë njësia bazë mësimdhënëse dhe kërkimore, e cila përfshin fusha homogjene kërkimore dhe arsimore. **[Ref.5_EN]** Departamentet mbështetin kërkimin e çdo anëtari të stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kërkimore (Ev. 26). **(Kapitulli II Standardi I.1)**

4.6 Universiteti mbështet projektet e kërkimit dhe zbatimit **(Ev. 26)**. UniBa siguron bashkëpunim me universitete publike dhe jopublike shqiptare dhe evropiane, në kuadër të programeve të ndryshme, si Erasmus, dhe ka nënshkruar marrëveshje me universitete të

tjera, ose partnerë nga qeveria qendrore dhe vendore, biznese, etj. [Ref.15_EN; Ref.1_EN; Ref17_EN] (*Kapitulli II Standardi I.2*)

4.7 Universiteti ka laboratorë të ndryshëm që përdoren për procesin e mësimdhënies, por edhe për kërkimin **[Ref.52_AL]**, të cilët janë të pajisur me pajisjet e blera në kuadër të projekteve të ndryshme. **[Ref.52_AL]** UniBa organizon konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare ku stafi prezanton risi dhe novacione shkencore. Stafi akademik i Universiteti publikon punime kërkimore në revista ndërkombëtare të indeksuara. **[Ref.9_EN]** Universiteti publikon periodikisht revistën e vet “Gjeopolitika”, e cila është një revistë e indeksuar në portalin e Bibliotekës Online të Evropës Qendrore dhe Lindore (C.E.E.O.L). **(Kapitulli II Standardi I.3)**

4.8 Kërkimi shkencor i aplikuar dhe novacioni përqendrohen në fusha si drejtësia, qeverisja, shoqëria, ekonomia, etj., siç pohohet në rregulloren e Universitetit “Barleti” . **[Ref.3_EN; Ref2_EN]** Ura lidhëse ndërmjet Departamenteve dhe strukturës së Kërkimit është Koordinatori i Kërkimit dhe Novacionit, në bashkëpunim me Zëvendës Rektorin për Kërkimin Shkencor të Aplikuar dhe Novacionin. Ata kontribuojnë në hartimin e raporteve, analizës, konferencave, ngritjeve në kategori, etj. **[Ref.3_EN; Ref.9_EN]** **(Kapitulli II Standardi I.4)**

4.9 Universiteti ka përcaktuar prioritetet e veta shkencore dhe mbështet stafin akademik që të marrë pjesë në projekte kërkimore bashkëpunuese, ose që të ndjekë punë kërkimore individuale **[Ref.33_AL; Mbledhja 3]** **(Kapitulli II Standardi I.5)**

4.10 UniBA ka përcaktuar prioritetet e kërkimit shkencor, ka objektiva të qarta dhe ka përgatitur një strategji zhvillimi. Ka raporte të përgatitura nga njësi të ndryshme lidhur me veprimtarinë shkencore. **[Ref.2_EN; Ref.8_EN; Ref.9_EN]** Studentët janë përfshirë në grupe të kërkimit shkencor, ku ata kryejnë kërkimin e tyre sipas fushave të kërkimit dhe kapaciteteve të Departamentit. **[RVV f. 34; Mbledhjet 4,5]** Projektet janë zbatuar nëpërmjet grupit Barleti. **[Ref.1_EN]** UniBa ka marrëveshje të ndryshme institucionale me institucione të tjera të huaja dhe ka organizuar shumë aktivitete ndërkombëtare **[Ref.16_EN]** **(Kapitulli II Standardi I.6)**

4.11 UniBA ndjek një politikë mbështetëse për publikimin e rezultateve në fushat e kërkimit shkencor, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, siç janë konferencat, workshop-et. **[Ref.9_EN; Ref.16EN; Mbledhja 3]** Qendra BRIDGE ka një kontribut në promovimin e kulturës së kërkimit shkencor. Gjetjet shkencore janë paraqitur edhe në tezat Bsc dhe Msc **[RVV. f. 34; Mbledhjet 4-5]** **(Kapitulli II Standardi I.7)**

4.12 UniBa ka komisione/borde që vlerësojnë progresin e rezultatit të kërkimit shkencor. Stafi akademik dhe studiuesit janë nxitur të ndjekin nisma kërkimore dhe rezultatet janë publikuar në revista ndërkombëtare. **[Ref.9_EN]** Stafi akademik është mbështetur lidhur me pjesëmarrjen në konferenca, publikimin në revista ndërkombëtare nga Shtëpia Botuese “Dudaj”, pjesë e Grupit “Barleti”. Stafi akademik raporton çdo vit në lidhje me aktivitetet kërkimore dhe botimet **[Ref.9_EN]** **(Kapitulli II Standardi 1.8)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë rekomandim në këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1. Pranimi i studentëve është në përputhje me politikat e Universitetit. **[Ref.3_EN; Ref.11_EN]** Universiteti ka vendosur lidhje me Drejtorinë për Arsimin Parauniversitar pranë MASR-së dhe organizon vizita në shkollë për t'i pajisur nxënësit e shkollës së mesme me informacion në lidhje me programet e studimit. Nxënësit e shkollës së mesme janë kontaktuar nëpërmjet emailit, rrjeteve sociale, telefonatave. Pranimi mbështetet edhe nga stafi akademik. Raportet staf/student i përmbushin kërkesat ligjore. **Ref.52.7_AL] (Kapitulli I Standardi III.1)**

5.2. Dekani i Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, Departamenti i Koordinatorëve, dhe vetë pedagogët janë përgjegjës për informimin dhe këshillimin e studentëve. **[Ref.3_EN]** I gjithë stafi dhe studentët kanë adresë të brendshme emaili që përdoret për komunikimin e brendshëm. Gjithashtu, ata përdorin mjete të komunikimit të jashtëm si media elektronike dhe e shkruar, faqja zyrtare e internetit e UniBA, etj. **(Kapitulli I Standardi III.2)**

5.3. UniBa ka mekanizma për udhëzimin, konsultimin dhe këshillimin e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në fazën e diplomimit. **[RVV, f. 36; Mbledhjet 3,4]** Broshura dhe fletëpalosjet janë gjithëpërfshirëse dhe të dobishme. Në faqen e internetit ofrohet informacion i detajuar për programet e studimit në të gjitha nivelet. **[Ref.3_EN] (Kapitulli I Standardi III.3)**

5.4. Universiteti është angazhuar të ofrojë mbështetje për kategoritë e veçanta të studentëve. **[Ref.1_EN; Ref.13_EN]** Bursat jepen për kategori të ndryshme studentësh. **[Ref.40_AL]** Për studentët me arritje kombëtare/ndërkombëtare në sporte ofrohet mbështetje financiare. **[Ref.36_EN] (Kapitulli I Standardi III.4)**

5.5. Biblioteka fizike dhe elektronike e Universitetit ofron literaturë në shqip dhe në gjuhë të huaja në fusha të ndryshme. Studentët dhe stafi kanë akses në bibliotekën online JSTOR dhe në revista akademike. Biblioteka e Universiteti pasurohet vazhdimisht sipas nevojave të departamenteve dhe me kërkesë. **[Ref.13/B_EN; Ref.58_EN]** Shtëpia Botuese "Dudaj", pjesë e Grupit "Barleti", ka botuar tekste të ndryshme shkollore të hartuara nga stafi akademik i UniBA. **(Kapitulli I Standardi III.5)**

5.6. Studentët përfitojnë mbështetje nëpërmjet rrjetit të shërbimeve studentore. **[Ref.3_EN; Ref.13/B_EN; Ref.32_AL; Ref.33_AL]** UniBa ofron infrastrukturë moderne, me kampusin e ri, me ambientet sportive, palestra, të cilat përdoren jo vetëm në kuadër të programeve të studimit, por edhe për nevoja argëtimi të studentëve. Për studentët që vizitojnë ambientet, ofrohen edhe shërbime të tjera si mensa, bibliotekë, sallë kompjuterash, etj. **(Kapitulli I Standardi III.6)**

5.7. Universiteti nxit jetën studentore dhe veprimtaritë jashtëkurrikulare që koordinohen nga Dekani i Studentëve dhe Klubet Studentore. **[Ref.33_AL; Ref.38_EN]** Ka gjithsej 15 klube studentore, **[Ref.33_AL]** të cilat në bashkëpunim me Zyrën e Dekanit të Studentëve organizojnë aktivitete të ndryshme, si forume,

workshop-e, programe trajnimi. **[Ref.33_AL]** UniBa publikon revistën "Politika dhe qeverisja".

[Ref.31_AL] Universiteti ka një ekip volejboli për femra, "Barleti Volley", i cili luan në superligë dhe lojtaret janë studente ose ish studente të UniBa. **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se zhvillimi i klubeve studentore dhe aktiviteteve sportive është një karakteristikë e praktikës së mirë. (Kapitulli I Standardi III.8)**

5.8. Zyra e Alumnit dhe e Planifikimit të Karrierës është përgjegjëse për ndjekjen e punësimit të të diplomuarve, dhe kjo realizohet duke mbajtur kontakte me studentët alumni. Kjo zyrë ka mbajtur regjistra me të dhëna për punësimin e alumnit, të cilët janë përditësuar periodikisht. UniBa ka struktura që organizojnë aktivitete dhe që ofrojnë shërbime për studentët. Bordet e Karrierës në nivel departamenti i udhëzojnë dhe ndihmojnë studentët që të integrohen në tregun e punës **[Ref.19_AL] (Kapitulli I Standardi III.9)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Ka një ekip volejboli për femra që luan në superligë, si dhe 15 klube studentore aktive që organizojnë aktivitete si forume, workshop-e, programe trajnimi, **(Kapitulli I Standardi III.8)**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë rekomandim në këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Lista e evidencave

Lista 1

Dokumentet në këtë listë janë dorëzuar nga institucioni për të shoqëruar raportin e vetëvlerësimit dhe për t'u shfaqur në faqen e menaxhimit të APAAL-it në rubrikën faza e vetëvlerësimit të procesit. Në raport, këto dokumente referohen si **Ref.1_EN**, **Ref.53_AL**, etj.

1. Shkresa Përcjellëse ASCAL.pdf
2. Raporti i Vetëvlerësimit UNIBA 2021 hiperlinkë_EN.pdf.
2. Raporti i Vetëvlerësimit i skanuar dhe nënshkruar_AL.pdf.
2. Raporti i Vetëvlerësimit i skanuar dhe nënshkruar_EN.pdf.
2. Raporti i Vetëvlerësimit me hiperlinkë_AL.pdf.
3. Vetëdeklarimi Institucional_AL.pdf.
- 1_AL. Statuti_AL.pdf.
- 1_EN. Statuti i Universitetit Barleti_EN.pdf.
- 2_EN. Strategjia e zhvillimit institucional_EN.pdf
- 2_AL. Strategjia institucionale_AL.pdf
- 3_AL. Rregullorja e UNIBA_AL.pdf
- 3_EN. Rregullorja e UniBa_EN.pdf
- 4_AL. Rregullorja e Fakultetit_AL.pdf
- 4_EN. Rregullorja e Fakultetit_EN.pdf
- 5_AL. Rregullorja e Departamentit_AL.pdf
- 5_EN. Rregullorja e Departamentit_EN.pdf
- 6_EN. Rregullorja e programit të diplomës Bachelor_EN.pdf
- 6_AL. Rregullorja e programit të studimit Bachelor_AL.pdf
- 7_AL. Rregullorja e programit Master_AL.pdf
- 7_EN. Rregullorja e programit Master_EN.pdf
- 8_AL. Raporti Vjetor 2019-2020_AL.pdf
- 8_EN. Raporti Vjetor 2019-2020_EN.pdf
- 9_AL. Raporti vjetor shkencor 19-20_AL.pdf

9_EN. Raporti vjetor i kërkimit shkencor 2019-2020_EN.pdf
10_AL. Lista e stafit akademik AL.pdf
10_AL. Lista e stafit akademik të kualifikuar jashtë
vendit_AL.pdf
11_AL. Lista e mbledhjeve të Senatit 2015-
2020_AL.pdf
11_EN. Lista e mbledhjeve të
Senatit_EN.pdf
12_EN. Mbledhjet e
Bordit_EN.pdf
12_AL. Lista e mbledhjeve të
Bordit_AL.pdf
13_EN. Lista e vendimeve të
Rektoratit/Rektorit_EN.pdf
13_EN. Lista e vendimeve të Rektorit dhe Rektoratit
2015+.pdf
14_AL. Lista e vendimeve të
Senatit_AL.pdf
14_EN. Lista e vendimeve të
Senatit_EN.pdf
15_AL. Lista e marrëveshjeve
ndërkombëtare_AL.pdf
16_AL. Lista e aktiviteteve
ndërkombëtare_AL.pdf

17_AL. A Strategjia e ndërkombëtarizimit_AL.pdf
 17_EN. A Strategjia e ndërkombëtarizimit_EN.pdf
 18_AL. B Lista e marrëveshjes së mobilitetit të studentëve_AL.pdf
 19_AL. Lista e aktiviteteve të UNIBA 2015+_AL.pdf
 20_AL. Lista e konferencave, workshop-eve dhe trajnimeve 2015+_AL.pdf
 21_AL. Alumnit e punësuar në grupin Barleti_AL.pdf
 22_AL. A Të dhënat e punësimit të studentëve_AL.pdf
 22_AL. B Plani i Karrierës dhe Alumnit_AL.pdf
 22_AL. C Modeli i studimit të tregut_AL.pdf
 23_AL. Rregullorja e protokollit dhe arkivit_AL.pdf
 25_EN. Modeli i provimit të diplomës_EN.pdf
 25_AL. Modeli i tezës_AL.pdf
 26_AL. Kërkimi dhe zbatimi i projekteve_AL.pdf
 27_AL. Rregullorja e zyrës mbi performancën_AL.pdf
 27_EN. Rregullorja e vlerësimit të performancës_EN.pdf
 28_AL. Manuali për mësimin online 2020-2021_AL.pdf
 29_AL. Rregullorja e njësisë së sigurimit të cilësisë dhe kurrikulave_AL.pdf
 29_EN. Rregullorja e njësisë së sigurimit të cilësisë_EN.pdf
 30_AL. Intraneti i UNIBA_AL.pdf
 31_AL. Broshurat informuese_AL.pdf
 31_AL. Revista studentore1_AL.pdf
 31_AL. Revista studentore2_AL.pdf
 32_AL. Manuali i rekrutimit, transferimit dhe pranimit_AL.pdf
 33_AL. Organizimi dhe aktivitetet e klubeve studentore_AL.pdf
 34_EN. Procedura e informimit të studentëve_EN.pdf
 34_AL. Procedura e informimit të studentëve_AL.pdf
 35_EN. Rregullorja e zyrës së karrierës dhe alumnit_EN.pdf
 35_AL. Rregullorja e zyrave studentore_AL.pdf
 36_EN. Raport mbi studentët e angazhuar me bursa_AL.pdf
 36_EN. Raport mbi aktivizimin e studentëve_EN.pdf
 37_AL. Pyetëtori i studentëve, njësia e sigurimit të cilësisë_AL.pdf
 38_EN. Manuali i klubeve studentore_EN.pdf
 38_AL. Manuali i klubeve studentore_AL.pdf
 39_AL. Rregullorja e Këshillit Studentor_AL.pdf
 39_EN. Rregullorja mbi zgjedhjet studentore_EN.pdf
 40_AL. Udhëzim i Administratorit mbi bursat_AL.pdf
 41_AL. A Paketa e praktikës BA_AL.pdf
 41_AL. B Manuali i tezës përfundimtare, studimet Master_AL.pdf
 42_AL. A Modelet e planeve të programit_AL.pdf
 42_AL. B Suplementi i diplomës Master_AL.pdf
 43_AL. A Modeli i syllabusit Ba_AL.pdf
 43_AL. B Modeli i syllabusit Ma_AL.pdf
 44_AL. Email për mbledhjen e Senatit_AL.pdf
 45_AL. Rregullorja e brendshme e transferimit të studimeve_AL.pdf

46_AL. Manuali i burimeve
njerëzore_AL.pdf

46_EN. Manuali i burimeve
njerëzore_EN.pdf

47_AL. Modeli i kontratës për stafin me kohë
të plotë_AL.pdf

47_EN. Kontrata individuale e punës_EN.pdf

48_AL. Plani i Biznesit_AL.pdf

49_AL. Burimet financiare të
UNIBA_AL.pdf

50_AL. Raporti i
auditimit_AL.pdf

51_AL. Ngarkesa
mësimore_AL.pdf

52_AL. Të dhëna mbi
infrastrukturën_AL.pdf

52.1._AL. Certifikatë pronësie_AL.pdf

52.2._AL. Planimetria e kampusit të ri_AL.pdf

52.3._AL. Planimetria e kampusit 1 dhe 2
_AL.pdf

52.4._AL. Pajisjet dhe labororët në kampuset ekzistuese_AL.pdf

52.5._AL. dhe 52.6._EN. Pajisjet dhe labororët në kampusin e ri_AL.pdf

52.7._AL. Raport nga MASR mbi certifikimin e kapaciteteve_AL.pdf

52.8._AL. Masat higjiene-sanitare dhe kundër zjarrit,
etj._AL.pdf

52.9._AL. Portali
studentor_AL.pdf

53._AL. Strategjia e
marketingut_AL.pdf

Lista

2

Dokumentet në këtë listë iu paraqitën institucionit pas kërkesës së ekipit të vlerësimit të jashtëm për të qartësuar dokumentet fillestare mbështetëse dhe për t'i hedhur në faqen e menaxhimi të APAAL-it në fazën e vlerësimit të dokumentacionit të procesit.

Ev. 1 Udhëzim 61 Këshilli i vlerësimit të perform.pdf

Ev. 2 dhe Ev. 6 Lista e stafit rritje akademike + kualifikimi 3 vitet e fundit.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Akuadrom.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Green Garden.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Klinika Rusi.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Palestra Praktika.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe QSUT.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Salus.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Spitali i Traumës.pdf

Ev. 4 Marrëveshje UniBa dhe Teniss Tirana.pdf

Ev. 5 Lista e pajisjeve sportive.pdf

Ev. 6 Planimetria e ndryshimit të kampusit 1.pdf

Ev. 7 Minutat e mbledhjes Departamenti i edukimit dhe trajnimit.pdf

Ev. 7 Procesverbal mbledhje departamenti i ekonomisë, sipërmarrjes dhe financës.pdf

Ev. 7 Raporti i mbledhjes së departamentit nr. 11 dt. 17.02.2021.pdf

Procesverb

alet.pdf

Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës

Gjatë gjithë raportit, mbledhjet janë referuar duke përdorur shkurtime **Mbledhja 1**, **Mbledhja 2**, etj.:

Dita 1: E martë, 22 qershor 2021

- 08:30 -09:00 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Koordinatorin Institucional.
- 09:00 - 09:30 Mbledhja 1: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Rektorin.
- 09:45 - 10:45 Mbledhja 2: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon anëtarët e Senatit Akademik.
- 11:00 - 12:00 Mbledhja 3: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon stafin e nivelit të lartë të Universitetit.
- 12:15 - 13:30 Mbledhja 4: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të parë.
- 14:30 - 15:45 Mbledhja 5: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të dytë.
- 16:00 - 17:00 Mbledhja 6: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup nga partnerët e jashtëm dhe alumnit.
- 12:16 - 13:30 Mbledhja 5: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të dytë.

Dita 2 : E enjte, 23 qershor 2021

- 09:30 - 10:30 Mbledhja 7: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup të stafit akademik dhe të qendrave kërkimore.
- 10:45 - 11:45 Mbledhja 8: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon drejtuesit e lartë.
- 13:00 - 13:45 Mbledhja 9: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon stafin administrativ, përgjegjës për mbështetjen dhe shërbimet ndaj studentëve.
- 14:00 - 14:45 Mbledhja 10: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit
- 15:30 - 15:45 Mbledhja 11: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Rektorin